

Fjalori i shqipes zyrtare është vetëm gjysma e së vërtetës. Intervistë me studiuesin dhe përkthyesin e njohur Robert Elsie

E vërteta e madhe na rrëfen që kanadezi, Robert Elsie, ishte njëri nga ata që kishte më shumë merita ndër fituesit e tjerë të “pendës së argjendtë” që shpërndau Ministria e Kulturës të enjten në mbrëmje. Kjo u duk qartë nga duartrokitjet e përzemërta që publiku i dhuroi atij gjatë ceremonisë. E me siguri do t’ia vlente për ta vlerëuar edhe më tepër, sikur një mendje e kujdesshme të ndiqte gjithë kontributin e tij në vite, që ka dhënë Elsie për të rritur imazhin e letërsisë shqipe në botë, imazhin e letërsisë së një vendi të vogël që botës i serviret keq. Megjithatë, Robert Elsie beson tek vlerat krijuese të këtij populli, duke gjetur mrekullitë në trashëgiminë e mëparshme dhe vlerat letrare të shpallura në kohë të ndryshme. Është ai që ka kërkuar i pari dhe i fundit, ndoshta. Ende kërkon e mundohet të gjejë nëpër botë një shtëpi botuese për letërsinë shqipe, kudo që të jetë, në Amerikë, ose gjetkë në Europë. E kur nuk e gjen këtë mundësi, përsëri Elsie tregohet “kokëfortë”; të gjitha veprat letrare të përkthyesit, studimet për letërsinë shqipe, e vlerësimet për këtë kulturë i ka hedhur në “bibliotekën e metropolit ndërkombëtar”, në faqet e internetit. “Është e vështirë, thotë ai, që të ketë një përkrahje kulturore shqiptare, që të ketë një vend ku të botohet ajo kulturë, megjithëse ka”. Këto shqetësime ai t’i thotë me zemër në dorë. Dhe kur e sheh se si bisedon në shqip, tërë shqetësimet e tij për kulturën tonë, harron fare se Elsie është një i huaj. Kanadezi di disa gjëra më shumë se ne, sepse ka kërkuar nëpër Shqipëri e trevat shqipfolëse gjithçka që i është dashur, sidomos fjalë, e akoma më me lakmi letërsi gojore. Ka shkuar deri në Plavë e në Guci, ka takuar shqiptarë, ka takuar gjuhën tonë që në fjalorin aktual të shqipes ka ardhur i gjymtë, aq i gjymtuar saqë përkthyesit e shqipes në gjuhë të huaj do ta kenë të gjatë mundin për ta përshtatur një vepër të shkrimtarëve shqiptarë në gjuhët përkatëse. Për ta bërë këtë punë mirë e për të sfiduar këtë mangësi të pafalshme, vetë Robert Elsie është nga të rrallët të huaj që ka takuar njerëz që flasin në dialektet e tyre deri në zonat më të thella. Ka qëndruar me ta, me qëllim që të mbledhë, ende pa u zhdukur, fjalët që mungojnë në shqipen e cinguar zyrtare. Një tjetër imazh të shfaqet kur bisedon vetëm pak minuta me Elsie-n. Pas bisedave të tilla lind dilema se cila do të ishte më e mirë për t’ia rrëfyer publikut pas kësaj bisede; një përshkrim ku thuhet të gjitha, një intervistë, apo një bisedë. Mes kësaj dileme që do ta kishte çdo njeri që përpiqet të shkruajë, studiuesin dhe përkthyesin Robert Elsie do ta njihni më thjeshtë dhe më mirë nëpërmjet disa rrëfimeve të tij në një intervistë të veçantë, dhënë për gazetën Tema.

Intervista:

Letërsia shqipe në internet. S’ka shtëpi botuese. Në mendjen e studiuesit dhe përkthyesit Robert Elsie janë shumë shkrimtarë shqiptarë. Cilin do të kujtoni në këto çaste që flasim?

Martin Camaj. Kohët e fundit kam përkthyer 10-15 poezitë e tij dhe më pëlqejnë shumë. Kam pasur disa vështirësi në përkthim, çështje interpretimi gjithmonë, por mua më pëlqejnë shumë. Prozën e tij e kam lexuar më pak. Por poezitë e tij i vlerësoj shumë.

Edhe pse Martin Camaj ishte i mërguar në Europë, studiuesit shqiptarë e kanë përcaktuar poezinë e tij me veçori kombëtare, si poet që përdor gjuhën e zanafillës, me fjalë nga rrënjët e

saj të vjetra. Si keni mundur ju të punoni me poezitë e tij, sepse fjalori i shqipes zyrtare nuk është aq i plotë sa do t'ju ndihmonte në këtë rast?

Gjuha letrare, siç është në atë fjalor, nuk është e plotë fare. Kjo është e vërtetë. Është gjynah, sepse është gjithë pasuria e gjuhës së veriut që mungon. Edhe në jug ka fjalë që nuk janë aty. Unë vuaj shumë për fjalor, sepse unë kur lexoj letërsi shqiptare dhe kur has një fjalë që nuk e kuptoj, zakonisht nuk e gjej në fjalorin e Akademisë. Kjo më mërzit shumë. Ka një fjalor tjetër që është më mirë, është ai i Oksfordit, Oksford Shqip-Anglisht. Aty gjej zakonisht fjalë që dua unë dhe prandaj them që fjalori i shqipes zyrtare është vetëm gjysma e gjuhës së vërtetë.

Këto probleme që keni zbuluar ju gjatë punës suaj, Zoti Elsie, sapo kanë filluar të preken në konferencat e fundit gjuhësore. Le të shpresojmë se një ditë do të keni një fjalor më të dobishëm. Si u ndjetë me vlerësimin që ju bëri Ministria e Kulturës në Tiranë?

Është nder i madh për mua që munda të fitoj çmimin “Penda e Argjendtë”. Nuk di si t’ju them më tepër. Për fat të keq ka shumë pak përkthyes të letërsisë shqiptare në gjuhë të huaj. Ka shumë për të bërë në këtë fushë, por unë po u jap ndihmesën time. Nuk e di se si do të pranohet në botë. Puna ime është për të prezantuar kulturën shqiptare, por se si do të vlerësohet më tej, kjo është puna e lexuesit.

Cilët do të jenë autorët e fundit që ju do të prezantoni në botë prej letërsisë shqipe?

Unë kam përkthyer mjaft autorë, por problemi im kryesor është për të gjetur një shtëpi botuese për të botuar përkthimet me letërsi shqiptare. Është shumë e vështirë. Kërkoj një shtëpi në Amerikë apo në Angli, por ata nuk ka shumë interes për letërsinë e huaj në përgjithësi dhe aq më tepër për një letërsi që vjen nga një kulturë e vogël dhe nuk e njohin. Nuk ka shumë interes, kështu që shumicën e përkthimeve të mia i kam vendosur në një faqe në internet. Këto ia jap falas lexuesit të interesuar. Kushdo ka në faqen time të internetit afërsisht 50 autorë. Ka përkthime të poezisë e të prozës, pra gjëra të ndryshme që i shtoj herë pas here. Kur kam kohë dhe gjej diçka që më pëlqen, e vendos aty. Më pas mund të ketë edhe ndonjë botim.

A do të ketë shpresa për atë shtëpi botuese që bëtë fjalë më sipër?

Varet nga imazhi i Shqipërisë. Shqipëria nuk ka një imazh të mirë në botën e jashtme. Imazhi i vendit tuaj ndërtohet nga lajmet që jepen për krimin e organizuar, nga ngjarjet e fundit në Greqi, ku rrëmbehet një autobus në Athinë, etj. Ngjarje të tilla krijojnë një imazh negativ. Letërsia mund të ndihmojë të përmirësoj imazhin e Shqipërisë.

Sikur të mos mjaftonte përkthimi i shumë autorëve të letërsisë shqipe, bërë nga Ju, Zoti Elsie, jeni kthyer edhe letërsisë së vjetër gojore, kryesisht “Eposit të Kreshnikëve.” Si shkuat kaq larg?

Jam përpjekur ta njoh letërsinë shqipe në epoka të ndryshme. Jam marrë edhe me letërsinë gojore. Ngacmimi për këtë të fundit më lindi nga eposi i kreshnikëve që më ka pëlqyer shumë. Më ka mahnitur me faktin që është letërsi epike, por ka humor. Kjo gjë më ka tërhequr shumë. Letërsia gojore më ka nxitur kohët e fundit të merrem edhe me Fishtën. Kam pasur në dorë përkthimin e “Lahutës së Malësisë”.

Ky lajm ka ardhur kohë më parë në median shqiptare. Cilat kanë qenë vështirësitë që keni hasur në përkthimin e kësaj vepre?

Kjo vepër është mjaft e vështirë, jo vetëm për faktin se ajo është shkruar në gegënishten letrare, por Fishta brenda gegënishtes ka një gjuhë mjaft të ndërlikuar e shumë fjalë të rralla e shumë shprehje që nuk përkthehen kollaj. Në fillim, të them të drejtën, kisha mjaft vështirësi. Veçanërisht këngët e para ishin shumë më të vështira, por më vonë unë ua mora dorën dhe besoj që botimi ka dalë i bukur. Shpresoj që të gjej një shtëpi botuese. Ky është problemi kryesor.

Çfarë keni bërë konkretisht për të zbuluar enigmat e gjuhës së vjetër shqipe. Përveç punës me fjalorin?

Së pari, m'u desh të kuptoja kulturën e veriut që është një kulturë e veçantë. Është gjithashtu një pjesë e rëndësishme e kulturës shqiptare. Kam udhëtuar në veri, në drejtim të Shkodrës, në zonat malore të saj e deri në Kosovë. Sivjet kam qenë deri në Plavë e në Guci në Malin e Zi, ku flitet një gjuhë shqipe shumë e bukur e shumë e pastër, një e folme si e atyre malësorëve që kam hasur kur kisha lexuar tek Fishta, kur e përktheja. Nuk do t'i kisha kuptuar fshatarët e Gucisë pa lexuar Fishtën.

E pas kësaj ekspedite gjuhësore, ku ka arritur puna juaj me "Lahutën e Malësisë"?

Lahuta e Malësisë ka përfunduar. U bënë më shumë se tri vjet punë, sepse është një epos i gjatë. Janë më shumë se 15 mijë vargje. Pra përkthimi i kësaj vepre kërkoj shumë kohë. Epika letrare e Fishtës është shumë e ndërlikuar. Habitem në fakt se, siç e shoh unë me syrin e përkthyesit, epika historike është shumë më lehtë sesa Fishta për t'u përkthyer. Përkthehen dhjetë faqe të kreshnikëve për aq kohë sa do një faqe e Fishtës.

Si e shpjegon përkthyesi këtë dukuri?

Është ngarkesa letrare që kjo vepër ka. Fishta ishte shkrimtar, ishte letrar dhe qëllimisht ka përdorur fjalë të rralla të shqipes, disa forma të zbukurimit, që nuk ndodhin në letërsinë gojore.

Epika ka fjalë më të vjetra të shqipes, variante të shkëputura të fjalëve të sotme. Si mundët ju të depërtoni në këtë tekst?

Është e vërtetë që ka fjalë shumë të vjetra dhe prapë po t'i kthehemi fjalorit të Akademisë, shihet se aty nuk janë. Ato janë pjesë e kulturës shqiptare, pjesë e gjuhës shqipe, dhe nuk gjenden në fjalor.

Për "Eposin e Kreshnikëve", çfarë informacioni ka pasur më parë bota e studiuesve të huaj?

Shumë pak. Për fat ka një paralelizëm me eposin e sllavëve të jugut. Të dy kanë ngjashmëri. Kanë një burim të përbashkët, në fakt. Bota ka njohur eposin sllav, variantin e boshnjakëve shumë herët në vitet '30 nga shkencëtarët e Harvardit, Milman Pari dhe Albert Lord, të cilët kishin udhëtuar në Jugosllavi, në Bosnje, në Malin e Zi, dhe në Sanxhak për të mbledhur eposin. Ata dinin serbokroatisht dhe janë marrë me eposin sllav. Kurse nga pesë këngëtarët që i kishin në Sanxhak, katër ishin shqiptarë dhe e këndonin eposin shqip dhe boshnjakçe. Shkencëtarët më vonë janë marrë vetëm me variantin e të kënduarit boshnjakçe, sepse gjuhën shqipe nuk e dinin, por janë ruajtur inçizime edhe në shqip.

Nëse keni lexuar studiuesit shqiptar për replikat me variantin e studiuesve bosnjakë se kujt i përket eposi, cila është përgjigja juaj?

Ndoshta kjo është pyetja që nuk duhet shtruar. Prejardhja është e përbashkët. Eposi ekziston në dy gjuhë, në disa variante. Ka vështirësi për të bërë ndarje, sepse versioni i sotëm, siç e kemi të ruajtur, varion nga shekulli 17-të - 18-të. Nuk është shumë i vjetër. Natyrisht që mund të ketë edhe shtresime më të lashta. Kontradita se kush është më i hershëm vjen nga fakti se ka më shumë material të botuar nga varianti në sllavisht, kurse shqip ka shumë pak material të botuar. Thonë se në arkiva ka të tjera materiale. Sidomos në Prishtinë, në Institutin Albanologjik, ka pasur shumë material. Ka shumë inçizime nga lahutarët e fundit. Edhe këtu në Tiranë në Institutin e Kulturës Popullore do të ketë shumë materiale, por për fat të keq ky material ka mbetur i pabotuar.

Keni takuar ju vetë lahutarë?

Po, kam takuar dhe janë njerëz të mrekullueshëm. Mua më habitin ata kur i shoh në atë botën e tyre. Një fakt është shumë interesant; ka patur letërsi epike kudo në Europë, por kudo ka përfunduar. Nuk ekziston më si organizëm i gjallë. Vetëm në botën shqiptare lahutarët ekzistojnë akoma, ku e ruajnë epikën edhe sot. Kurse eposi serbokroat nuk ekziston më. Them se nuk ka më lahutarë të gjallë sllavë. Ka patur në vitet '30-të - '40-të, por tani nuk ka më, kurse në malësinë shqiptare ka lahutarë të gjallë që dinë repertorin e eposit me trashëgimi gojore. Kjo ka rëndësi.

Mbaruat "Lahutën", me çfarë po merret Robert Elsie aktualisht?

Me Mitrush Kutelin. Ai ka një tregim interesant. Ka vështirësi për ta përkthyer shqipen në anglisht, por mua gjatë punës sime më shqetëson më shumë fakti se në botimet në gjuhën shqipe nuk bëhen redaktimet e librave. Ato botohen me shumë gabime drejtshkrimore. Ka shumë, shumë gabime, edhe në botimet më luksoze. Më habit kjo pakujdesi. Kam disa libra të autorëve shqiptarë në duar. Kam edhe një antologji të tregimeve bashkëkohore shqiptare që do të botohet në Amerikë, dy poetë që do të botohen vitin e ardhshëm; njëri Visar Zhiti e tjetri Azem Shkreli. "Lahuta..." do botuar tani. Së fundmi, kam në dorë një histori të re të letërsisë shqiptare.

Intervistoi: Dhurata Hamzai:

[Botuar në gazetën *Tema*, Tiranë, 18.12.2004 / Published in the newspaper *Tema*, Tirana, 18.12.2004. Republished in: <http://www.shkoder.net/fjala/2004/elsie.htm>]